



Funded by
the European Union

Plotësimi dhe ndryshimi i udhëzimit administrativ për të përfshirë kategoritë e stimujve financiare dhe mbështetjes me grante për aktivitetet e ekonomisë qarkore

Përmbledhje e politikave #01

Prill 2025

Autorët:

Prof. Dr. Besnik A. Krasniqi, Ekspert i Ekonomisë Qarkore
Dr. Albana Rexha, Eksperte e Integritimit Gjinor
Urim Xharavina, Rilindja Gjellbër
Lendita Kastrati, People in Need Kosovo

Mohimi i përgjegjesisë:

Kjo publikim është përgatitur si pjesë e projektit “CE4GR - Ekonomia Qarkore për Tranzicionin e Gjelbër në Kosovë”, i financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe i zbatuar nga People in Need dhe Rilindja Gjelbër. Pikëpamjet, opinionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë publikim janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë.

Përmbledhje

Ky dokument i politikave mbështet plotësimin dhe ndryshimin e udhëzimeve administrative ekzistuese për të përfshirë stimujt financiarë dhe mbështetjen me grante për aktivitetet e ekonomisë qarkore, me qëllim të krijimit të një kornize ligjore mbështetës që mundëson dhe përshpejton tranzicionin drejt një ekonomie qarkore.

Ekziston një konsensus i gjerë në mesin e akademikëve dhe politikëbërësve në nivel global se iniciativat e ekonomisë qarkore janë në rritje dhe se mbështetja qeveritare është thelbësore për të nxitur bizneset që të përvetësojnë parimet e ekonomisë qarkore. Në Kosovë, ekonomia qarkore është ende në fazën e saj të hershme, me vetëm një numër të kufizuar biznesesh që zbatojnë parime të tilla. Prandaj, ekziston një nevojë urgjente për të rishikuar mekanizmat ekzistues të nxitjes dhe për të promovuar iniciativat e ekonomisë qarkore, si për gratë ashtu edhe për burrat në sektorin privat, veçanërisht në këtë fazë themelore të zhvillimit.

Duke u mbështetur në provat dhe raportet ndërkombëtare, ky dokument i politikave argumenton se politikat e hartuara mirë mund të sjellin përfitime të konsiderueshme për bizneset, duke përfshirë rritjen e produktivitetit, inovacionin dhe përdorimin më efikas të burimeve, ndërkohë që kontribuojnë gjithashtu në qëndrueshmërinë mjedisore. Dokumenti shqyrton avantazhet e ekonomisë qarkore dhe potencialin e saj për të ndikuar pozitivisht si në bizneset ashtu edhe në ekonominë në përgjithësi.

Në shtjellimin e përgjigjeve të politikave ndaj këtyre sfidave, dokumenti paraqet prova që tregojnë se skemat mbështetëse qeveritare dhe komunale mund të rrisin ndjeshëm produktivitetin e ekonomisë qarkore dhe rezultatet mjedisore. Një rekomandim kyç është rishikimi i një udhëzimi administrativ në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), si dhe i rregulloreve përkatëse për stimujt financiarë dhe grantet e ofruara nga ministritë e linjës dhe komunat. Ky rishikim duhet të synojë:

Krijimin e skemave të dedikuara të përshtatura posaçërisht për të mbështetur bizneset e ekonomisë qarkore, duke siguruar qasje dhe gjithëpërfshirje, veçanërisht për ndërmarrjet e udhëhequra nga gratë dhe grupet e marginalizuara; ose
Përshtatjen e skemave ekzistuese duke shtuar kriteret e ekonomisë qarkore në vlerësimet e granteve, ndërkohë që integron konsideratat e barazisë gjinore dhe fuqizimit gjatë gjithë procesit.

Në mënyrë specifike, dokumenti i politikave rekomandon ndryshimin si në vijim:

- Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, për të përfshirë në mënyrë të qartë komponentët e ekonomisë qarkore në skemat e tyre të granteve, duke siguruar që këto skema të jenë të përgjegjshme ndaj çështjeve gjinore dhe gjithëpërfshirëse për grupet e nën-përfaqësuar.
- Skemat e granteve në nivel komunal, për të integruar kriteret e ekonomisë qarkore në thirrjet publike për mbështetje financiare, së bashku me masa për barazinë gjinore që promovojnë iniciativat e udhëhequra nga gratë dhe gjithëpërfshirëse në aspektin social.

Këto ndryshime do të:

- △ Nxisin iniciativat e ekonomisë qarkore të udhëhequra nga bizneset.
- △ Rrisin ndërgjegjësimin për praktikën e qëndrueshme.
- △ Forcojnë përfshirjen e grave dhe komuniteteve pakicë në zhvillimin e ekonomisë qarkore.
- △ Rrisin pjesëmarrjen e grave në mundësitë për financim publik.

Pse është e rëndësishme ekonomia qarkore?

Modeli tradicional “merr, prodho, hidhe” nuk është më i qëndrueshëm në ekonominë e sotme. Kalimi në ekonomi rrethore, ku materialet ripërdoren, produktet riciklohen dhe mbeturinat minimizohen, promovon qëndrueshmërinë, nxit rritjen ekonomike dhe përmirëson mbrojtjen e mjedisit¹. Bizneset që zbatojnë strategji qarkore përfitojnë nga ulja e kostove, rritja e inovacionit dhe përmirësimi i reputacionit të markës, veçanërisht pasi konsumatorët gjithnjë e më shumë i japin përparësi qëndrueshmërisë². Për më tepër, praktikatat e ekonomisë qarkore nxisin krijimin e vendeve të reja të punës dhe hapin mundësi në sektorët e gjelbër, siç janë riciklimi, energjia e ripërtëritshme dhe prodhimi i qëndrueshëm³.

Duke ruajtur burimet, duke zvogëluar emetimet dhe duke minimizuar mbeturinat, praktikatat qarkore luajnë rol thelbësor në luftimin e ndryshimeve klimatike⁴. Megjithatë, kalimi në ekonomi qarkore kërkon investime të konsiderueshme, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të). Për këtë arsye, mbështetja e qeverisë është thelbësore për ta mundësuar këtë transformim. Një mekanizëm efektiv është Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), i cili mund të luajë rol kyç duke ofruar garanci për kredi të gjelbra. Këto garanci ulin rrezikun financiar dhe ndihmojnë në tërheqjen e kapitalit privat për projekte në energjinë e ripërtëritshme, eficiencën e burimeve dhe prodhimin e qëndrueshëm. Kjo jo vetëm që nxit rritjen ekonomike, por gjithashtu mbështet qëndrueshmërinë mjedisore⁵.

Përveç kësaj, qeveria duhet të mbështesë masat për “uljen e rrezikut” brenda institucioneve financiare, për të lehtësuar rrjedhën më të madhe të kapitalit privat në investime të gjelbra. FKGK mund të krijojë një dritare të dedikuar për financim të gjelbër, për të ofruar garanci për institucionet financiare, duke ulur kështu rrezikun e dhënies së kredive për projekte të fokusuara në: energjinë e ripërtëritshme, eficiencën e burimeve, zvogëlimin e mbeturinave dhe praktikatat e prodhimit qarkor.

Duke ulur rrezikun e investimeve në ekonominë e gjelbër, FKGK mund të përshpejtojë angazhimin e sektorit privat në iniciativat qarkore, të nxisë inovacionin, të krijojë vende pune të gjelbra dhe të mbështesë kalimin e Kosovës drejt një ekonomie më të qëndrueshme dhe reziliente, plotësisht të përafruar me objektivat globale për qëndrueshmëri.

¹ Geissdoerfer, M., Savaget, P., Bocken, N.M.P., & Hultink, E.J. (2017). “Ekonomia Qarkore – Një paradigmë e re e qëndrueshmërisë?” *Journal of Cleaner Production*, 143, 757-768. <https://doi.org/10.1016/j.jclepro.2016.12.048>.

² Bocken, N.M.P., Short, S.W., Rana, P., & Evans, S. (2016). “Rishikimi i literaturës dhe praktikës për zhvillimin e arketipeve të modelit të qëndrueshëm të biznesit” *Journal of Cleaner Production*, 65, 42-56. <https://doi.org/10.1016/j.jclepro.2013.11.039>.

³ Korhonen, J., Honkasalo, A., & Seppälä, J. (2018). “Ekonomia qarkore: Koncepti dhe kufizimet e saj.” *Ecological Economics*, 143, 37-46. <https://doi.org/10.1016/j.ecolecon.2017.06.041>.

⁴ Fondacioni Ellen MacArthur. (2015). “Drejt një ekonomie qarkore: Arsyeimi i biznesit për një tranzicion të përshpejtuar.” Fondacioni Ellen MacArthur.

⁵ Forumi Ekonomik Botëror. (2020). “Përshpejtimi i tranzicionit drejt ekonomisë qarkore.” Forumi Ekonomik Botëror. Ligji nr. 03/I-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Përfitimet potenciale të ekonomisë qarkore për qëndrueshmërinë dhe konkurrueshmërinë: Kalimi nga ekonomia lineare në ekonomi qarkore ofron një qasje transformuese për zhvillimin ekonomik, duke theksuar qëndrueshmërinë, eficiencën e burimeve dhe konkurrueshmërinë afatgjate. Duke i dhënë përparësi zvogëlimit të mbeturinave, përdorimit eficient të burimeve dhe inovacionit, ekonomia qarkore sjell përfitime të shumëfishta: mbrojtje të mjedisit, kursime në kosto për bizneset dhe zhvillim të produkteve dhe shërbimeve inovative. Një raport nga Fondacioni Ellen MacArthur vlerëson se bizneset evropiane mund të kursejnë deri në 600 miliardë euro në vit duke zbatuar praktikatat e ekonomisë qarkore.

Për më tepër, kalimi në modelin qarkor forcon qëndrueshmërinë duke zvogëluar varësinë nga lëndët e para të importuara. Riciklimi dhe ripërdorimi i materialeve ndihmon në zbutjen e rreziqeve që lidhen me zinxhirët e furnizimit të lëndëve të para, siç janë luhatjet e çmimeve, disponueshmëria e kufizuar dhe varësia në rritje nga importi, sfida që janë gjithnjë e më të theksuara në ekonominë globale të sotme⁶.

Të dhënat nga Bashkimi Evropian theksojnë përmasat e kësaj çështjeje: në vitin 2023, vlera totale e tregtisë (importet plus eksportet) të lëndëve të para ndërmjet BE-së dhe pjesës tjetër të botës arriti në 165 miliardë euro. Për më tepër, sipas vlerësimeve të Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian (KESE), lëndët e para përbëjnë nga 30% deri në 50% të kostos së prodhimit për kompanitë. Kjo nxjerr në pah ndikimin e mundshëm ekonomik dhe përparësinë strategjike të përsheptimit të kalimit drejt ekonomisë qarkore.

Meqenëse Bashkimi Evropian importon gati gjysmën e lëndëve të para që konsumon, Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian (KESE) thekson se përmirësimi i eficiencës së burimeve mund të kursejë deri në 600 miliardë euro në vit. Çdo kompani duhet të kontribuojë në këtë ndryshim dhe të përfitojë nga përfitimet ekonomike që ofrojnë modelet e reja të biznesit rrethor.

Tabela 1 paraqet përfitimet e gjera ekonomike të zbatimit të qasjes së ekonomisë qarkore, të kategorizuara sipas përfitimeve për bizneset, shoqërinë dhe politikëbërësit. Kjo kornizë gjithëpërfshirëse thekson vlerën shumëdimensionale të praktikave të orientuara kah qëndrueshmëria, duke treguar se si ato mbështesin rritjen ekonomike, mbrojtjen e mjedisit dhe mirëqenien shoqërore.

⁶ Shërbimi Kërkimor i Parlamentit Evropian. (2023). *Ekonomia Qarkore: përkufizimi, rëndësia dhe përfitimet*. Në dispozicion në <https://www.europarl.europa.eu/topics/en/article/20151201STO05603/circular-economy-definition-importance-and-benefits>

Tabela 1: Përfitimet nga zbatimi i ekonomisë qarkore

Kategoria	Përfitimet për bizneset	Përfitimet për shoqërinë	Përfitimet për politikëbërësit
Zhvillimi ekonomik dhe konkurrenca	△ Nxit inovacionin në dizajnimin e produkteve dhe modelet e biznesit. △ Përmirëson konkurrencën përmes reduktimit të varësisë nga tregjet e paqëndrueshme të lëndëve të para. △ Krijon tregje dhe mundësi të reja biznesi në sektorët e gjelbër.	△ Mbështet ekonomitë lokale përmes industrive të reja. △ Nxit një kulturë të qëndrueshmërisë dhe inovacionit.	△ Pozicionon vendet si udhëheqëse globale në qëndrueshmëri. △ Lehtëson tregtinë ndërkombëtare në teknologji të gjelbra.
Krijimi i vendeve të punës dhe diversifikimi i aftësive	△ Zhvillim i aftësive në industri të qëndrueshme, siç janë riparimi, rinovimi dhe rikuperimi i materialeve.	△ Krijon mundësi punësimi dhe ul papunësinë. △ Ofron trajnim në aftësi të reja të gjelbra.	△ Promovon zhvillimin e fuqisë punëtore në përputhje me industritë e së ardhmes.
Mbrojtja e mjedisit	△ Redukton mbeturinat operacionale dhe kostot e pajtueshmërisë.	△ Përmirëson cilësinë e ajrit dhe ujit. △ Minimizon ndotjen nga mbeturinat.	△ Ndihmon në përmbushjen e objektivave mjedisore, siç është reduktimi i emetimeve.
Siguria e burimeve	△ Redukton varësinë nga lëndët e para të importuara. △ Rrit qëndrueshmërinë e zinxhirit të furnizimit.	△ Rrit disponueshmërinë e materialeve thelbësore.	△ Forcon sigurinë kombëtare përmes pavarësisë së burimeve.
Kursimet në kosto për bizneset dhe shoqërinë	△ Ul kostot e prodhimit përmes përdorimit efikas të burimeve. △ Ul shpenzimet për menaxhimin e mbeturinave.	△ Redukton kostot për konsumatorët përmes ripërdorimit qarkor.	△ Ul shpenzimet publike për menaxhimin e mbeturinave dhe operacionet në deponi.
Përmirësimi i shëndetit publik dhe cilësisë së jetës	△ Përmirëson qëndrueshmërinë operacionale, duke reduktuar përgjegjësitë për ndotje. △ Rrit përgjegjësinë shoqërore të korporatave.	△ Promovon mjedise urbane më të pastra. △ Minimizon rreziqet shëndetësore të ndërlidhura me ndotjen.	△ Mbështet objektivat e shëndetit publik dhe planifikimin për qëndrueshmëri urbane.
Përafrimi me Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm	△ Rrit vlerën e markës përmes pajtueshmërisë me kornizat globale siç janë OZHQ-të.	△ Kontribuon në arritjen e objektivave për zhvillim të qëndrueshëm në nivel komuniteti.	△ Mbështet marrëveshjet globale siç është Marrëveshja e Parisit dhe OZHQ-të.
Stimulimi financiar dhe mundësitë e investimit	△ Tërheq financime të gjelbra dhe partneritete publiko-private. △ Hap qasje në kapital sipërmarrës dhe investime të QSM-së.	△ Inkurajon inovacionin në zgjidhje të qëndrueshme.	△ Stimulon investimet përmes politikave dhe stimuljve të gjelbër.

Burimi: Përshtatur nga korniza të ndryshme kërkimore në fushën e qëndrueshmërisë dhe ekonomisë.

Ekonomia Qarkore në Kosovë: Sfidat dhe mundësitë

Pavarësisht rëndësisë gjithnjë në rritje të ekonomisë qarkore në nivel global, Kosova vazhdon të ndjekë kryesisht modelin linear “merr-prodho-hedh”.

Edhe pse Ligji për Mbeturina është miratuar në vitin 2012, së bashku me hartimin e strategjive për menaxhimin e mbeturinave, korniza ligjore e Kosovës ende nuk e përfshin në mënyrë të plotë parimin e ekonomisë qarkore. Në vitin 2019, vendi ka gjeneruar rreth 452,000 tonë mbeturina komunale, që i bie 253 kg për kokë banori, afërsisht gjysma e mesatares së Bashkimit Evropian prej 502 kg për kokë banori⁷. Për më tepër, ndonëse 32% e mbeturinave në Kosovë janë të riciklueshme dhe 40% janë të biodegradueshme, vetëm 5% riciklohen në të vërtetë.

Sipas Agjencisë Evropiane për Mjedis (2022), pengesat kryesore për një menaxhim efektiv të mbeturinave në Kosovë përfshijnë mungesën e financimit të mjaftueshëm, infrastrukturën e dobët, trajtimin informal të mbeturinave dhe zbatimin e dobët të rregulloreve. Megjithatë, është arritur njëfarë progresi: mbulimi me shërbime të grumbullimit të mbeturinave është përmirësuar vitet e fundit, duke arritur në 95.2%, çka ka kontribuar në uljen e numrit të deponive ilegale⁸. Raporti për Kosovën (2024) tregon një rënie të ndjeshme të numrit të deponive ilegale, nga 747 në vitin 2022 në 373 në vitin 2023, që paraqet një ulje prej 374 lokacionesh⁹.

Në vitet e fundit, sektori privat ka treguar një angazhim gjithnjë e në rritje në praktikat e qëndrueshme mjedisore, duke u përafëruar me trendët globale për përgjegjësinë ekologjike (USAID, 2021)¹⁰.

Sipas Administratës Ndërkombëtare të Tregtisë të SHBA-ve (ITA, 2021)¹¹, sektori i menaxhimit të mbeturinave dhe riciklimit në Kosovë konsiderohet një fushë premtuese për investime. Niveli i ulët i zhvillimit të këtij sektori, së bashku me rritjen e gjenerimit të mbeturinave dhe infrastrukturën e pamjaftueshme, krijon mundësi për bizneset që të ofrojnë shërbime siç janë mbledhja e mbeturinave, riciklimi dhe furnizimi me pajisje dhe teknologji.

Megjithatë, fokusi i politikave të Kosovës duhet të përqendrohet drejt promovimit të modeleve të biznesit të ekonomisë qarkore, të cilat janë rigjeneruese në thelb dhe synojnë të reduktojnë ose eliminojnë plotësisht mbeturinat¹².

Ndërsa interesi është në rritje, iniciativat e ekonomisë qarkore të udhëhequra nga bizneset në Kosovë mbeten të kufizuara dhe kërkojnë mbështetje më të fuqishme institucionale dhe stimuj shtesë. Megjithatë, fokusi i politikave të Kosovës duhet gjithnjë e më shumë të zhvendoset drejt miratimit të modeleve të biznesit të ekonomisë qarkore, të cilat janë rigjeneruese në thelb dhe synojnë të reduktojnë ose eliminojnë mbeturinat kudo që është e mundur¹³.

⁷ Agjencia Evropiane e Mjedisit. (2022). “Menaxhimi i mbeturinave komunale në vendet e Ballkanit Perëndimor” Përmbledhje nr. 06.2022. Në dispozicion në <https://www.eea.europa.eu/publications/municipal-waste-management-in-western>

⁸ Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit (2024) RAPORTI I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE KOMUNALE NË KOSOVË ([https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/RAPORT I MBETURINAVE KOMUNALE 2022.pdf](https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/RAPORT%20I%20MBETURINAVE%20KOMUNALE%202022.pdf) qasur në Maj 2025)

⁹ https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf

¹⁰ USAID. (2021). Sektori privat udhëheq përpjekjen për një Kosovë më të gjelbër. USAID. Marrë nga <https://www.usaid.gov/kosovo/news-information/news/private-sector-leadingcharge-greener-kosovo>

¹¹ ITA. (2021). Menaxhimi dhe Riciklimi i Mbeturinave në Kosovë. ITA - Administrata Ndërkombëtare e Tregtisë Marrë nga <https://www.trade.gov/country-commercialguides/kosovo-waste-management-and-recycling>

¹² Krasniqi, B. (2022). “Analiza e Zinxhirit të Vlerës së Riciklimit në Kosovë”, Oda Ekonomike e Kosovës. Prishtinë, Kosovë.

¹³ Krasniqi, B. (2022). “Analiza e Zinxhirit të Vlerës së Riciklimit në Kosovë”, Oda Ekonomike e Kosovës. Prishtinë, Kosovë.

Dekarbonizimi është një tjetër dimension kritik i qëndrueshmërisë. Në Kosovë, tranzicioni drejt ekonomisë qarkore (EQ) dhe procesit të dekarbonizimit përballet me sfida të mëdha, veçanërisht në sektorët e ngrohjes dhe të transportit. Vazhdimi i varësisë së vendit nga thëngjilli për ngrohje, sidomos në zonat urbane si Prishtina, e përkeqëson ndotjen e ajrit dhe paraqet rreziqe serioze për shëndetin publik¹⁴. Hulumtimet tregojnë se termocentralet me djegie të thëngjillit dhe përdorimi i tij në amvisëri për ngrohje janë ndër kontribuuesit kryesorë të cilësisë së dobët të ajrit në rajon. Këto emetime janë të lidhura ngushtë me shtimin e sëmundjeve respiratore dhe kardiovaskulare në mesin e popullatës.

Implikimet mjedisore nga varësia e vazhdueshme e Kosovës ndaj thëngjillit janë të mëdha. Sektori energjetik i vendit kryesisht bazohet në thëngjill, ku rreth 91.43% të kapacitetit të instaluar për prodhimin e energjisë elektrike varet nga ky burim¹⁵. Kjo varësi jo vetëm që e pengon përpjekjen e vendit për dekarbonizim, por gjithashtu sjell pasoja serioze për shëndetin publik për shkak të ndotjes së ajrit dhe emetimeve përkatëse. Përveç kësaj, sektori i transportit në Kosovë paraqet një sfidë të madhe në kontekstin më të gjerë të ekonomisë qarkore (EQ) dhe të dekarbonizimit, duke kërkuar vëmendje të menjëhershme dhe investime strategjike në zgjidhje më të pastra dhe më të qëndrueshme të mobilitetit.

Sektori i transportit në Kosovë vazhdon të varet shumë nga lëndët djegëse fosile, duke kontribuar ndjeshëm në emetimin e gazrave serrë dhe ndotjen e ajrit. Nevoja urgjente për zgjidhje të qëndrueshme në transport theksohet edhe më shumë nga rritja e shpejtë e popullsisë urbane dhe shtimi përkatës i përdorimit të automjeteve – faktorë që përshpejtojnë degradimin mjedisor dhe paraqesin rreziqe serioze për shëndetin publik¹⁶.

Kalimi drejt zgjidhjeve më të pastra të transportit, siç janë automjetet elektrike dhe sistemet e avancuara të transportit publik, është thelbësor për uljen e emetimeve dhe krijimin e mjediseve urbane më të shëndetshme. Përballja me këto sfida kërkon një qasje gjithëpërfshirëse dhe ndërsektoriale që përfshin përmirësimin e efikasitetit të energjisë, promovimin e përdorimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe avancimin e strategjive të qëndrueshme të planifikimit urban. Integrimi i teknologjive të energjisë së ripërtëritshme, veçanërisht energjisë solare dhe asaj të erës, në përzierjen energjetike të Kosovës, mund të reduktojë ndjeshëm varësinë e vendit nga thëngjilli dhe të sjellë përmirësime të dukshme në cilësinë e ajrit dhe në rezultatet shëndetësore të popullatës¹⁷.

¹⁴ Bajčinovci, S. (2019). "Dilema mjedisore dhe klimatike: Thëngjill për ngrohje ose ajër t; pastër për frymëmarrje: Rasti i Prishtinës." *Teknologjitë Mjedisore dhe Klimatike*, 23(1), 1-10. doi:10.2478/rtuct-2019-0003.

Kittner, N., et al. (2018). "Përmbajtja e metaleve të rënda në thëngjill e përkeqëson rrezikun shëndetësor të ndërlidhur me ndotjen e ajrit: Rasti i thëngjillit të linjtit në Kosovë." *Shkenca dhe Teknologjia Mjedisore*, 52(6), 3475-3483. doi:10.1021/acs.est.7b04254.

¹⁵ Lajqi, A., et al. (2020). "Analiza e potencialit për shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme në sektorin e energjisë elektrike të Kosovës." *Mjediset*, 7(6), 49. doi:10.3390/environments7060049.

¹⁶ Gjukaj, A. (2024). "Furnizimi me energji përmes sfidave: Analizë e krizës energjetike në Ballkanin Perëndimor gjatë pandemisë." *Hightech and Innovation Journal*, 5(1), 1-10. doi:10.28991/hij-2024-05-01-08.

¹⁷ Lajqi, A., et al. (2020). "Analiza e potencialit për shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme në sektorin e energjisë elektrike të Kosovës." *Mjediset*, 7(6), 49. doi:10.3390/environments7060049.

Kadriaj, A., & Jeminaj, A. (2023). "Sfidat dhe dilemat e transformimit të energjisë elektrike nga energjia termike në energji alternative në Kosovë." *International Scientific Journal Monte*, 3(2), 38-45. doi:10.33807/monte.20232838.

Për më tepër, zhvillimi i ndërtesave dhe infrastrukturës së qëndrueshme luan rol kyç në përmirësimin e efijencës së energjisë dhe në reduktimin e gjurmës së karbonit në rajon¹⁸. Të dhënat e fundit tregojnë për mungesë të theksuar të ndërgjegjësimit lidhur me konceptet e ekonomisë qarkore në mesin e bizneseve. Për shembull, edhe brenda sektorit të riciklimit, 64% e ndërmarrjeve nuk janë të njohura me konceptin e ekonomisë qarkore (Krasniqi, 2022)¹⁹. Pothuajse gjysma e të anketuarve (46%) e shohin zbatimin e praktikave të ekonomisë qarkore (EQ) vetëm mesatarisht të rëndësishëm në reduktimin e përdorimit të lëndëve të para dhe të energjisë. Për më tepër, vërehet një pasiguri ose përkushtim i kufizuar, ku vetëm 37% përkatësisht 63% të të anketuarve e njohin rëndësinë e këtyre praktikave, duke theksuar nevojën për ndërgjegjësim më të madh dhe angazhim të synuar.

Si përfundim, Kosova përballlet me sfida të mëdha në fushat siç janë menaxhimi i mbeturinave, dekarbonizimi i sektorit të transportit dhe prodhimi i energjisë së ripërtëritshme. Këto sfida rëndohen edhe më shumë nga shkalla e ulët e riciklimit, zbatimi i kufizuar i iniciativave të ekonomisë qarkore (EQ) dhe mungesa e ndërgjegjësimit të bizneseve për përfitimet potenciale të praktikave qarkore. Prioriteti i ulët që u jepet praktikave të EQ-së nga ana e ndërmarrjeve thekson nevojën urgjente për stimuj të fuqishëm qeveritarë dhe mbështetje të synuar financiare për të inkurajuar bizneset që të zbatojnë dhe investojnë në modele afariste qarkore, duke hapur rrugën për një ekonomi më të qëndrueshme dhe më reziliente.

Përmes krijimit të mekanizmave të synuar të financimit dhe kornizave përkrahëse të politikave, qeveria mund të stimulojë ndërmarrjet që të zbatojnë praktika afariste inovative dhe rigjeneruese, duke përshpejtuar kështu tranzicionin drejt një ekonomie të qëndrueshme dhe me efijencë të lartë në përdorimin e burimeve.

¹⁸ Hoxha, A., & Shala, A. (2019). "Përfitimet dhe sfidat e ndërtesave të qëndrueshme në Prishtinë, Kosovë." *Objektet*, 37(5/6), 319-331. doi:10.1108/f-08-2018-0097.

Hoxha, A., & Lecaj, D. (2022). "Pengesat rregullatore për zbatimin e ndërtesave të qëndrueshme në Kosovë." *Menaxhimi i Pronës*, 40(1), 1-15. doi:10.1108/pm-01-2022-0008.

¹⁹ Krasniqi, B. (2022). Analiza e zinxhirit të vlerës së riciklimit në Kosovë. Prishtinë: Oda Ekonomike e Kosovës.

Gjinia dhe Ekonomia Qarkore

Tranzicioni drejt modeleve afariste më inovative, siç është ekonomia qarkore (EQ), paraqet si sfida ashtu edhe mundësi për të çliruar potencialin ekonomik të grave dhe për të ndërtuar një të ardhme më të barabartë. Megjithatë, kalimi drejt modeleve afariste të EQ-së shpesh kërkon kompetenca të avancuara teknike dhe digjitale, të cilat mund të paraqesin pengesa të pabarabarta për gratë për shkak të boshllëqeve ekzistuese gjinore në qasjen në arsim dhe aftësim profesional në fushat e STEM²⁰. Gratë që punojnë në sektorë informalë dhe tradicionalë përballen me pengesa të mëdha në qasjen në mundësi për rikualifikim dhe avancim profesional, gjë që kufizon aftësinë e tyre për të përfituar nga rolet e reja që po dalin brenda ekonomisë qarkore (EQ) (ILO, 2022)²¹.

Tranzicioni drejt ekonomisë qarkore (EQ) dhe agjenda më e gjerë e dekarbonizimit mbartin pasoja të rëndësishme si për burrat ashtu edhe për gratë, veçanërisht në lidhje me modelet e punësimit, rreziqet shëndetësore dhe dinamikat familjare. Burrat shpesh janë të mbipërfaqësuar në sektorët me intensitet të lartë karboni, siç janë minierat, ngrohja dhe industritë e ndërtimit, të cilat jo vetëm që kontribuojnë kryesisht në degradimin mjedisor, por njihen edhe për rreziqe të konsiderueshme për shëndetin dhe sigurinë. Punëtorët në këta sektorë përballen me ekspozim të lartë ndaj sëmundjeve të frymëmarrjes dhe një sërë rreziqesh të tjera profesionale, duke nxjerrë në pah nevojën për qasje gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme gjinore ndaj tranzicioneve ekonomike dhe mjedisore²².

Rreziqet shëndetësore që ndërlidhen me këta sektorë përkeqësohen më tej nga ndotja mjedisore që ata gjenerojnë, pasoja këto që prekin në mënyrë disproporcionale komunitetet që ndodhen pranë këtyre veprimtarive.

Gratë, të cilat shpesh bartin përgjegjësinë kryesore për kujdesin ndaj familjes, janë veçanërisht të cenueshme ndaj këtyre pasojave shëndetësore. Kur fëmijët apo anëtarët e moshuar të familjes preken nga sëmundjet si pasojë e cilësisë së dobët të ajrit apo ekspozimit ndaj ndotësve, gratë kanë më shumë gjasa të tërhiqen nga fuqia punëtore për t'u kujdesur për ta. Kjo dinamikë kontribuon në një pjesëmarrje më të ulët të grave në fuqinë punëtore dhe përkeqëson pabarazitë gjinore në tregun e punës²³.

Ndikimet më të gjera ekonomike të rreziqeve mjedisore dhe shëndetësore janë të konsiderueshme. Një fuqi punëtore e prekur nga sëmundjet që lidhen me ndotjen zakonisht shfaq produktivitet më të ulët dhe i shkakton presion shtesë sistemit shëndetësor. Këto pasoja negative përhapen nëpër tërë ekonominë, duke theksuar urgjencën për kalim drejt industrive të qëndrueshme dhe të ndërgjegjshme ndaj shëndetit.

Në këtë kontekst, ekonomia qarkore (EQ) paraqet një alternativë tërheqëse—duke nxitur praktika të përgjegjshme ndaj mjedisit dhe duke reduktuar varësinë nga sektorët e dëmshëm me emetime të larta. Kur projektohet në mënyrë gjithëpërfshirëse, ekonomia qarkore ka potencial të nxisë një fuqi punëtore dhe shoqëri më të shëndetshme dhe më të barabartë²⁴.

Kosova ka miratuar disa ligje dhe korniza strategjike për të promovuar barazinë gjinore dhe për të mbështetur ndërmarrësinë e grave. Vlen të përmendet se Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020–2024 synon të integrojë perspektivën gjinore në të gjitha institucionet, politikat dhe programet.

²⁰ Saliba, M., Glutting, J. R., & Brown, E. G. (2023). Puna e denjë në ekonominë qarkore: Një përmbledhje e bazës ekzistuese të të dhënave. Ekonomia Qarkore, Amsterdam.

²¹ ILO (2022). Punësimi Botëror dhe Perspektiva Sociale: trendet 2023. Marrë nga: faqja e internetit e ILO-s

²² ILO (2014). Raporti i ILO-së “Sigurimi i shëndetit dhe sigurisë në punë në një klimë në ndryshim”.

²³ Castro et al. (2022). “Ekonomia qarkore dhe ndikimi i saj në qëndrueshmërinë mjedisore” doi:10.37955/cs.v6i4.286

²⁴ OBZHE (2023). “Bashkimi i Forcave për Barazi Gjinore” OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/67d48024-en>.

Megjithatë, në praktikë, legjislacioni që lidhet me barazinë gjinore nuk është i integruar mjaftueshëm me fusha të tjera kyçe të politikave, siç janë zhvillimi ekonomik dhe qëndrueshmëria mjedisore. Për më tepër, shumë instrumente financiare të destinuara për të mbështetur bizneset shpesh nuk arrijnë t’ju japin prioritet nevojave specifike të grave ose të sigurojnë qasje të barabartë në fonde dhe burime.

Qasja në financa mbetet një pengesë e vazhdueshme për gratë sipërmarrëse në Kosovë. Ndërmjet viteve 2022 dhe 2024, gjithsej 388 biznese përfituan nga skemat mbështetëse të KIESA-s, prej të cilave 297 ishin të udhëhequra nga burrat dhe vetëm 91 nga gratë, që do të thotë se gratë përbënin vetëm 23% të numrit të përgjithshëm të përfituesve²⁵.

Gjithashtu, KIESA nuk përcjellë shpërndarjen e fondeve sipas gjinisë. Megjithatë, bazuar në një analizë të thjeshtë proporcionale, vlerësohet se bizneset e udhëhequra nga gratë kanë përfituar më pak se 20% të mbi 8 milionë eurove të shpërndara në mbështetje financiare. Ky hendek i konsiderueshëm gjinor, si në qasjen ashtu edhe në ndarjen e burimeve, nënvizon barrierat strukturore që vazhdojnë të kufizojnë pjesëmarrjen ekonomike dhe ndërmarrësinë e grave.

Janë bërë disa përpjekje për të adresuar paparazitë gjinore në qasjen në financave. Për shembull, skema e granteve të KIESA-s për digjitalizimin e ndërmarrjeve përfshin një masë afirmative duke i dhënë 10 pikë shtesë bizneseve në pronësi të grave gjatë procesit të vlerësimit²⁶.

Për më tepër, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) ka themeluar një “Dritare për Kreditë e Grave”, e cila ofron instrumente financiare të përshtatura që mund të shfrytëzohen për të mbështetur pjesëmarrjen e grave në sektorët e ekonomisë qarkore.

Si përfundim, ndërthurja mes iniciativave të ekonomisë qarkore (EQ) dhe dinamikave gjinore është komplekse dhe thellësisht e ndërlikur. Ndërsa burrat janë kryesisht të punësuar në industri të rrezikshme dhe me emetime të larta karboni, gratë shpesh bartin barrën indirekte, veçanërisht përmes punës së papaguar të kujdesit që rrjedh nga ndikimet shëndetësore që lidhën me degradimin mjedisor.

Pa një projektim të qëllimshëm dhe gjithëpërfshirës të politikave, tranzicioni drejt ekonomisë qarkore rrezikon të përsëritë ose madje të thellojë paparazitë ekzistuese gjinore. Megjithatë, me kombinimin e duhur të politikave të synuara, sistemeve mbështetëse dhe qasjeve të ndjeshme gjinore, ekonomia qarkore ka potencial të fuqizojë gratë, të përmirësojë rezultatet e shëndetit publik dhe të kontribuojë në një ekonomi më gjithëpërfshirëse, të drejtë dhe reziliente për të gjithë.

²⁵ KIESA. (2025). Të dhënat për përfituesit e granteve 2022–2024. Siguruar nga Zef Dedaj përmes email-it, më 29 prill 2025.

²⁶ KIESA. (2025). Të dhënat për përfituesit e granteve 2022–2024. Siguruar nga Zef Dedaj përmes email-it, më 29 prill 2025.

Cili është problemi?

Kosova ka treguar përkushtimin e saj ndaj Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor duke miratuar disa dokumente strategjike që përcaktojnë rrugën drejt zhvillimit të qëndrueshëm. Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZ) 2030 shpreh vizionin afatgjatë për progresin e vendit, duke vendosur qëndrueshmërinë në qendër të saj²⁷.

Kornizat kryesore strategjike përfshijnë SKZH-në, Programin e Reformës Ekonomike dhe së fundmi, Udhërrëfyesin e Ekonomisë Qarkore për Kosovën. Udhërrëfyesi i Ekonomisë Qarkore në veçanti shënon një moment të rëndësishëm, pasi hedh themelet për tranzicionin e Kosovës drejt një ekonomie qarkore. Ai ofron një kornizë gjithëpërfshirëse për njohjen e forcave, aftësive dhe mundësive unike të vendit që mund të nxisin një transformim të suksesshëm qarkor²⁸.

Dokumentet strategjike të miratuara nga Qeveria e Kosovës (QK) janë në përputhje me kornizat kryesore ndërkombëtare dhe rajonale, duke përfshirë Marrëveshjen e Gjellbër Evropiane²⁹ Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) dhe Agjendën e Integritetit Evropian. Qeveria e Kosovës ka theksuar se zbatimi i këtyre objektivave strategjike do të realizohet përmes strategjive sektoriale dhe planeve institucionale të veprimit, duke siguruar mekanizma të qartë për zbatim, mbikëqyrje dhe harmonizim buxhetor. Në mënyrë specifike, objektivat e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (SKZH) do të përkthehen në objektiva strategjike brenda strategjive sektoriale. Këto, më pas, do të zëbërthehen në aktivitete operacionale me kode të caktuara buxhetore, duke mundësuar planifikim, koordinim dhe përgjegjshmëri më efektive gjatë zbatimit.

Megjithëse Qeveria e Kosovës (QK) ka përfshirë disa elemente të ekonomisë së gjellbër dhe asaj qarkore në kornizën e saj strategjike, ekziston ende nevojë urgjente për t'i operacionalizuar këto angazhime përmes zhvillimit të instrumenteve të reja të politikave, siç janë stimujt e drejtpërdrejtë financiarë për sektorin privat për të promovuar në mënyrë efektive praktikën e ekonomisë qarkore.

Për të siguruar zbatim më të mirë në nivel operacional, është thelbësore të ndryshohet Rregullorja për Subvencionet dhe Transferet, duke ua mundësuar si ministrive të linjës ashtu edhe komunave të hartojnë dhe zbatojnë nisma të përshtatura për ekonominë e gjellbër dhe atë qarkore. Këto iniciativa duhet të pasqyrojnë nevojat lokale, duke qenë në përputhje me kornizat strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare.

Për më tepër, ofrimi i stimujve financiarë dhe mbështetjes me grante për iniciativat e sektorit privat në ekonominë qarkore është thelbësor për forcimin e kapacitetit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për të ndërmarrë investime komplekse të gjelbra. Një mbështetje e tillë mund të veprojë si katalizator për transformimin e sektorit privat, duke ia mundësuar atij të përvetësojë praktika më të qëndrueshme dhe të ketë qasje më të mirë në mundësitë e financimit të gjellbër.

²⁷ Qeveria e Republikës së Kosovës. Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030. Në dispozicion në <https://kryeministri.rks-gov.net/sq/strategjia-e-zhvillimit-kombetar-2030/>

²⁸ Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturs. (2023). "Udhërrëfyesi i Ekonomisë Qarkore të Kosovës", në dispozicion në https://mmphi.rks-gov.net/MMPHIFolder/DocumentsFiles/2023_8171e270-643b-4de3-9387-91794084eb8b.pdf

²⁹ Për më shumë shihni Marrëveshjen për Industri të Pastër në https://commission.europa.eu/topics/eu-competitiveness/clean-industrial-deal_en
Komisioni Evropian ka përkufizuar Marrëveshjen për Industri të Pastër si vazhdim i Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane. Do të mbështetet në punën e BE-së për të kaluar në një ekonomi të qëndrueshme dhe do të përqendrohet në forcimin e industrisë dhe rritjen e konkurrueshmërisë brenda këtij konteksti

Në këtë kontekst, Agjenda e Gjelbër e Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor (AGJBP), e prezantuar në vitin 2020, dhe Plani i saj Ekonomik dhe i Investimeve për Ballkanin Perëndimor (PEIBP) që e shoqëron atë, ofrojnë mundësi të rëndësishme. Një shtyllë kyçe e AGJBP-së është rritja e konkurrueshmërisë së sektorit privat, me theks të veçantë në inovacion. Megjithatë, Kosova vazhdon të përballet me sfida të konsiderueshme në thithjen dhe shfrytëzimin efektiv të këtyre fondeve, kryesisht për shkak të kapacitetit të kufizuar të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për të zhvilluar dhe zbatuar strategji investimesh rrethore dhe të gjelbra.

Veprimet e rekomanduara: Ndryshimi i kornizës ligjore aktuale për subvencionet dhe transferet

Ndarja e granteve dhe subvencioneve në Kosovë rregullohet nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (shih kutinë 1). Ky ligj përcakton parametra të rreptë për të siguruar transparencë, llogaridhënie dhe disiplinë fiskale në menaxhimin e fondeve publike.

Sipas kësaj kornize ligjore, grantet dhe stimujt financiarë mund të ofrohen vetëm nëse ato autorizohen shprehimisht nga Ligj për Ndarjet Buxhetore. Të gjitha organizatat buxhetore duhet të përmbushin kushtet e përcaktuara në legjislacion.

Për më tepër, Ministri i Financave ka autoritetin ekskluziv për të nxjerrë rregulla dhe procedura të hollësishme për përzgjedhjen e përfituesve dhe përcaktimin e shumave të granteve. Këto rregullore kanë për qëllim të garantojnë që e gjithë mbështetja financiare të jetë në përputhje me objektivat e miratuara nga Kuvendi, duke nxitur kështu përdorimin efektiv, të barabartë dhe të përgjegjshëm të burimeve publike.

Kutia 1: LIGJI NR. 03/L-048 PËR MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË.

Neni 53. Kufizimet në Grante, Donacione dhe Subvencione

- 53.1 Asnjë organizatë buxhetore ose autoritet tjetër publik nuk mund të japin një grant, donacion ose subvencion për ndonjë person ose ndërmarrje, përveç dhe deri në masën që Ligji për Ndarjet Buxhetore autorizon posaçërisht dhe shprehimisht një grant, donacion ose subvencion të tillë.
- 53.2 Nëse në një ligj për ndarjet buxhetore autorizohet një organizatë buxhetore ose autoritet publik që të japë një grant, donacion ose subvencion për një ose më shumë persona dhe/ose ndërmarrje, atëherë kjo organizatë buxhetore ose ky autoritet publik duhet t'i përmbushin të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në Ligjin përkatës të Ndarjeve Buxhetore si dhe rregullat e nxjerra nga Ministri sipas paragrafit 3 të këtij neni gjatë dhënies së grantit, donacionit ose subvencionit.
- 53.3 Ministri është shprehimisht i autorizuar që të nxjerrë rregullat të cilat duhet të respektohen nga organizatat buxhetore ose autoritetet publike gjatë përzgjedhjes së pranuesit ose pranuesve si dhe përcaktimit të shumës ose shumave të cilat do të epen në formë të grantit, donacionit ose subvencionit. Këto rregulla duhet të sigurojnë që procesi të ketë për qëllim arritjen e synimeve të Kuvendit kur i njëjti e ka autorizuar grantin, donacionin ose subvencionin përkatës në ligjin përkatës për ndarjet buxhetore.

Sipas Rregullit për Shpenzimet e Parasë Publike, “Për çdo pagesë të subvencionit apo transferit duhet të ketë bazë të qartë juridike, d.m.th duhet të ketë ligj, rregullore ose vendim të institucionit përkatës që i mundëson organizatës specifike buxhetore ta bëjë një pagesë nga kjo kategori.”³⁰

³⁰ Rregull Financiare nr. 01/2013/– Shpenzimi i Parave Publike

Sa i përket kriterëve për ndarjen e subvencioneve, Neni 6 – Kriteret për Përzgjedhje të Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr. 01/2018 për Ndarjen e Mjeteve Financiare nga Kategoria Ekonomike të Subvencioneve dhe Transfereve, i nxjerrë nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), parashikon se ministria do të përkrahë aplikuesit të cilat janë të regjistruara në Republikën e Kosovës, dhe të cilat me projekt-propozime dëshmojnë që subvencionet e ndara do të ndikojnë në:

- △ Rritjen e investimeve brenda Republikës së Kosovës;
- △ Nxitjen e prodhimit vendor;
- △ Zgjerimin e kapaciteteve eksportuese;
- △ Promovimin e turizmit;
- △ Zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM);
- △ Përmirësimin e konkurrueshmërisë së NVM-v
- △ Hapjen e vendeve të reja të punës.³¹

Edhe pse shtatë kriteret e përzgjedhjes të ofruara nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) janë të rëndësishme për vlerësimin e projekt propozimeve, ne rekomandojmë futjen e një kriteri të dedikuar të fokusuar në ekonominë qarkore dhe iniciativat e biznesit të gjelbër.

Aktualisht, ndërsa disa veprime të ekonomisë qarkore mund të përputhen në mënyrë indirekte me kriteret ekzistuese, ato nuk trajtohen në mënyrë të qartë, gjë që kufizon efektivitetin e tyre në promovimin e qëndrueshmërisë dhe praktikave qarkore. Për të mbyllur këtë boshllëk politikash, ne propozojmë një ndryshim në udhëzimin administrativ duke shtuar një kriter të ri: 1.8. Promovimin e ekonomisë qarkore dhe iniciativave të biznesit të gjelbër. Kjo shtesë do të nënvizonte rëndësinë e qëndrueshmërisë dhe do të siguronte mbështetje të synuar për projektet që avancojnë modelet e biznesit qarkor dhe praktikatat e përgjegjshme ndaj mjedisit.

Paralelisht, Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) gjithashtu zbaton një skemë të dedikuar mbështetjeje për ndërmarrjet e reja, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe OJQ-të, që synon nxitjen e zhvillimit të balancuar rajonal. Rregullorja (GRK) nr. 21/2024 për Menaxhimin e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar, neni 22 (Kriteret e vlerësimit të projekt propozimeve) specifikon se kriteret e vlerësimit do të përshkruhen në detaje në çdo thirrje publike për aplikim. Fushat kryesore të vlerësimit janë:

- △ Kapaciteti financiar dhe operacional
- △ Relevanca e veprimit
- △ Efektshmëria dhe arritshmëria
- △ Qëndrueshmëria e projektit
- △ Buxheti dhe efektshmëria e kostos

Ne propozojmë që të futen kriteret shtesë vlerësimi për të njohur në mënyrë të qartë ekonominë qarkore dhe iniciativat e gjelbra. Projekteve që përfshijnë parimet e ekonomisë qarkore duhet t'u jepen pikë shtesë gjatë procesit të vlerësimit të granteve, duke nxitur inovacionin e qëndrueshëm. Për më tepër, ky propozim rekomandon përfshirjen e një komponenti gjinor me qëllim që procesi i vlerësimit të mbështesë gjithashtu barazinë gjinore, në veçanti përmes promovimit të pjesëmarrjes së bizneseve të drejtuara nga gratë dhe iniciativave që nxisin një tranzicion të gjelbër gjithëpërfshirës³².

³¹ Udhëzimin Administrativ nr. 01/2018 për Ndarjen e Mjeteve Financiare nga Kategoria Ekonomike e Subvencioneve dhe Transfereve

³² Rregullorja (QRK) – nr. 21/2024 Për Menaxhimin e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar Rajonal. Në dispozicion në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=55434>

Në nivel lokal, Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë³³ përcakton qartë kompetencat komunale si *“fushat e kompetencës lokale të caktuara posaçërisht për komunën përkatëse nga legjislacioni primar në fuqi për vetëqeverisjen lokale”*. Në përputhje me këtë kornizë, çdo organizatë buxhetore, duke përfshirë ministritë dhe komunat, duhet të miratojë një rregullore për ndarjen e subvencioneve³⁴, e cila bazohet në:

- Ligji për Vetëqeverisjen Lokale,
- Ligji Nr. 03/ L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë,
- Rregulli Financiar nr. 01/2013/MF – Shpenzimi i Fondeve Publike.

Kjo strukturë rregullatore kërkon që secili departament të përcaktojë kriteret e pranueshmërisë për përfituesit e subvencioneve. Është me rëndësi që komunat ruajnë drejtën për të integruar komponentët e ekonomisë qarkore (EQ) dhe barazisë gjinore në kriteret e tyre për ndarjen e granteve. Një qasje e tillë do të përforconte promovimin e praktikave të qëndrueshme dhe përfshirjen gjinore në nivel lokal, në përputhje me prioritetet kombëtare dhe të BE-së për tranzicionin e gjelbër.

³³ Për më shumë shih Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

³⁴ Këtu përdorim një shembull të rregullores për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Gjakovës, si ilustrim (Rregullorja për Subvencionet 2020, nr. 3560, në dispozicion në <https://kk.rks-gov.net/gjakove/wp-content/uploads/sites/2/2020/06/Rregulloreja-per-Subvencione-2020-nr.3560.pdf>

Përmirësimi i qasjes financiare për gratë dhe grupet e marginalizuara

Qeveria duhet t'i japë përparësi sigurimit që gratë dhe grupet e tjera të marginalizuara të kenë qasje të barabartë në burimet financiare. Kjo kërkon jo vetëm zhvillimin e programeve financiare gjithëpërfshirëse, por edhe zbatimin e masave të synuara për të adresuar boshllëqet ekzistuese.

Për ta arritur këtë, është thelbësore që Qeveria e Kosovës (QK) të angazhohet në mënyrë aktive me komunitetet e marginalizuara dhe të privuara nga të drejtat, duke përfshirë gratë, në mënyrë që të identifikojë dhe të eliminojë barrierat për qasje. Sigurimi që këto grupe të jenë të informuara dhe të afta të përfitojnë nga mundësitë financiare, veçanërisht në kontekstin e kalimit drejt një ekonomie rrethore, kërkon qasje proaktive, strategji të përshtatura të komunikimit dhe procedura të thjeshtuara administrative.

Për më tepër, për të rritur gjithëpërfshirjen në skemat e udhëhequra nga qeveria, autoritetet përkatëse duhet të shqyrtojnë futjen e stimuljeve të veçantë brenda skemave ekzistuese. Për shembull, dhënia e pikëve shtesë të vlerësimit për ndërmarrjet në pronësi të grave apo të grupeve minoritare do të promovonte pjesëmarrje dhe përfaqësim më të madh në iniciativat e zhvillimit ekonomik.

Përmes zbatimit të këtyre masave, QK mund të nxisë një ekosistem financiar më të drejtë dhe më gjithëpërfshirës, duke mundësuar që të gjitha segmentet e shoqërisë të kontribuojnë dhe të përfitojnë nga progresi ekonomik.

Falënderime për kontribuuesit

Përgatitja e këtij dokumenti të politikave është bërë e mundur falë kontributit të çmuar dhe mendimeve të palëve kryesore të interesit nga sektorë të ndryshëm. Ekspertiza e tyre, përvoja në terren dhe përkushtimi për avancimin e praktikave të qëndrueshme kanë luajtur rol thelbësor në formësimin e rekomandimeve të paraqitura në këtë dokument. Dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë të sinqertë për organizatat e mëposhtme për pjesëmarrjen e tyre aktive në procesin e konsultimit dhe hartimit:

Komuna e Gjakovës, Komuna e Prishtinës, Instituti për Politika Zhvillimore, KAMA – Shoqata e Kosovës për Marketing të Veshmbathjeve, AWESK – Shoqata e Grave në Sektorin e Energjisë në Kosovë, ESRA – Shoqata për Mjedisin dhe Përgjegjësinë Sociale, Instituti për Siguri Publike, INDEP, EGW – Ekokoswomen, Rrjeti i Organizatave për Zhvillim Rural, Klubi Rinor i Ferizajt, Izolimi Plast, Riciklimi i Qelqit në Kosovës.